

GLADIOLA DURMISHI (ELEZI)

**VEÇORI TË PËRGJITHSHME TË GJUHËS E TË STILIT NË
VEPRËN “ARKA E DJALLIT” TË DRITËRO AGOLLIT**

Abstrakt

Romani “Arka e djallit” është një roman që na jep mundësi të shumta studimi e interpretimi. Realizimet gjuhësore dhe artistike na japin shtysë për ta parë romanin në disa rrafshë dhe aspekte të ndryshme. Ne do të merremi me trajtimin e veçorive të përgjithshme të romanit. Romani paraqet interes të veçantë për të gjithë studiuesit, ai mund të shihet në kontekstin historik dhe shoqëror të kohës, mund të studiohet gjuha e veçantë popullore sa e thjeshtë aq edhe e përpunuar artistikisht, leksiku i pasur, frazeologjia, ndërtimet sintaksore të fjalive etj. Agolli ka një stil sa origjinal aq edhe të thjeshtë në dukje, kjo përshtypje të ngelet sa herë që lexon krijimtarinë letrare të autorit.

I referohemi, kryesisht, romanit me titull “Arka e djallit” për të parë me interes të veçantë jo vetëm realizimin e tij gjuhësor foljor, por edhe atë artistik e letrar në të njëjtën kohë. Vepra ka karakter tejet simbolik. Ajo kërkon një lexues me njohuri të thella teoriko-letrare. Interpretimi i saj nuk mund të realizohet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Pa realizuar një analizë kuptimore e stilistike, nuk mund të thellohem në atë gjuhësore qoftë sintaksore apo morfologjike...

Me anë të këtij studimi do dalin në pah veçoritë gjuhësore më të spikatura dhe më të përdorshme nga shkrimtari. Do të hasim studimin për fjalë të burimit popullor, nëse autori i përdor, krijon shumë fjalë të reja etj. Metoda që përdoret është vrojtimi i fjalëve, klasifikimi i fjalëve nëse ato janë fjalë të brumit popullor, fjalë dialektore apo krahinore si dhe një analizë e përgjithshme të romanit, duke e parë atë në disa rrafshë gjuhësore si: rrafshi fonetik, morfologjik, sintaksor, leksikor dhe ai stilistik. Për të realizuar një studim shterues do të shfrytëzojmë një literaturë të zgjedhur, e cila do të na udhëheqë në këtë studim. Gjithashtu, metoda përmes së cilës do të arrihen përfundimet është metoda e analizës dhe vëzhgimi i hollësishëm i fjalëve.

Fjalët kyç: analizë gjuhësore, rrafsh fonetik, morfologjik, sintaksor, stil individual, karakter simbolik, stil, gjuhë

Të studiosh një tekst letrar nuk është diçka e thjeshtë dhe e zakonshme, vepra letrare ka ndërtim të ndërlikuar dhe që të depërtohet me sukses në të, siç përmendëm edhe më sipër, duhen pasur një seri njohurish teoriko-letrare. Milivoj Solar në veprën e tij *“Hyrje në shkencën për letërsinë”* pohon se: *“Në veprën letrare fjalët janë përdorur në mënyrë të tillë që të kuptuarit ta orientojnë në drejtim jo të zakonshëm: gjuha në veprën letrare ndryshon nga gjuha në të folurit e përditshëm, e ky ndryshim nuk është thjesht një gabim”*.¹

Krijimtaria e një autori dallohet lehtësisht nga krijimtaria e një autori tjetër. Ky element dallues qëndron te gjuha dhe te stili që përshkon gjithë veprën e tij. Gjuha e veprës së Agollit është e dallueshme nga ajo e autorëve të tjerë. Për nga gjinitë, krijimtaria e Agollit është e larmishme. Gjuha e tij është e pasur, e thjeshtë dhe shumë e kuptueshme. Ai shquhet për stilin e tij i cili bazohet dhe te krijimtaria popullore. Agolli është shkrimtari i fshatit, i tokës, i bujqësisë dhe bagëtisë. Në veprën e Agollit e gjen veten protagonist bujku dhe bariu, malësori dhe fusharaku. Agolli u bë shkrimtari i tokës dhe i dashurisë për të, shkrimtari i filozofisë dhe i dhimbjes së madhe njerëzore. Nëpërmjet përshkrimit të fshatit me detaje, autori duket sikur e bën dhe lexuesin pjesë të tij. Agolli ndryshe nga Kadare nuk krijon shumë neologjizma, por ai krijon kompozita të reja duke u bazuar mbi brumin popullor. Thjeshtësia e komunikimit, mesazhet universale dhe shprehja e hapur e ndjeshmërisë janë shtyllat e forta ku mbështetet krijimtaria e Agollit. Në veprën e tij Agolli solli risi jo vetëm në strukturën narrative, por edhe në galerinë e personazheve të veta. Ata janë sa të çuditshëm aq edhe të zakonshëm, sa tragjikë aq edhe komikë, sa të thjeshtë aq edhe madhështorë. Frazeologjia e pasur popullore dhe filozofia jetësore e bëjnë veprën e Agollit më të lexuarën. Nëse shohim gjuhën e përdorur në romanin *“Arka e Djallit”* vëmë re se Agolli mbështetet shumë te fjalët e brumit popullor madje ai nga këto fjalë të brumit popullor arrin të krijojë kompozita popullore. Duket se në këtë roman Agolli përdor mjaft dendur si fjalë të dialektit gegë ashtu dhe të dialektit toskë, por një përdorim të dendur kanë dhe fjalët krahinore. Leksiku i përdorur në këtë roman është shumë i pasur dhe i larmishëm. Shkrimtari përdor fjalë të ligjërit libror, të ligjërit bisedor dhe të

¹ M. Solar, *Hyrje në shkencën për letërsinë*, Tiranë, 2006, f. 53.

përditshëm, përdor leksikon politiko-shoqëror dhe leksikon tekniko-shkencor. Por nëse e lexon veprën me kujdes sheh se mbizotëron leksiku rural. Agolli duke folur për fshatin, për bagëtinë, bujqësinë, për bimët, për kafshët, na jep me detaje jetën e fshatit. Autori përdor në veprën e tij shumë fjalë të burimit popullor, ai përdor shumë mallkime apo proverba të ndryshme nga brumi popullor. Një numër të paktë në vepër zënë arkaizmat, historizmat apo neologjizmat.

Mjeshtëria e madhe e Dritëro Agollit duket edhe në përdorimin e figurave letrare. Përdorim më të dendur gjen krahasimi, metafora, epiteti etj. Në roman përdoren dendur grotesku, satira për të goditur thellë çdo dukuri shoqërore që duket sikur është e fshehur.

Peshën kryesore të këtyre figurave e mbart simboli. Nga vetë titulli “Arka e djallit” kuptojmë se simboli është figura e djallit. Agolli ka zgjedhur pikërisht këtë simbol, pasi ai arrin të përcjellë më mirë mesazhin e gjithë veprës. Romani “Arka e djallit” ka në qendër të veprimit një shkrimtar, Sherif Abecenë. Detyra e tij është të zbulojë “arkën e djallit”, një senduk ku ruhen dorëshkrimet e ndaluara të një autori. “Djalli” që duhet të zbulojë shkrimtari nuk ka të bëjë me demonologjinë popullore, as me ndonjë qenie që tundon njeriun për të dalë nga rruga e perëndisë. “Djalli” është romani “Shakaja e ndaluar ose njeriu që e ndaluan të qeshë”, një vepër e ndaluar e shkrimtarit të dënuar Bamkë Dynjaja, jeta e të cilit është ndërlikuar në episode të paqarta, që mbeten enigmatike deri në fund dhe që lexuesi duhet t’i marrë me mend si shprehje disidence. Brenda “arkës agolliane”, ka terr e sajon plane për keqësi, ligësi dhe prapësi. Në këtë roman fraza është e gjatë dhe e përbërë. “Arka e djallit” shquhet sidomos për tregimin e realitetit dhe të situatave jetësore nëpërmjet satirës. Personazhet e “Arkës së djallit” janë shumë të gjetura dhe të goditura nga ana e autorit, ato qëndrojnë larg skematizimit, përkundrazi ato janë personazhe jetësore, të gjalla, normale dhe njerëzore. Secili prej tyre përfaqëson një arketip shoqëror dhe përcjell një mesazh të caktuar. Dialogu dhe monologu janë dy format kyçe të komunikimit të personazheve. Përdorim më të dendur në roman ka dialogu.

Personazhet duke dialoguar me njëri-tjetrin nxjerrin në pah karakteristikat, mendimet e tyre. Nëpërmjet dialogut personazhet e romanit zbulojnë mendimet e të tjerëve për çështje të ndryshme. Krahas dialogut, kemi dhe përdorim të monologut. Nëpërmjet monologut duket se personazhet zbulojnë edhe skutat më të fshehta të tyre, frikërat apo mendimet që s’i thonë dot me zë të lartë. Agolli e bën më të besueshme veprën nëpërmjet detejeve apo përshkrimit të fshatit që ai përdor. Ngjarjet

në roman duke u treguar me detaje, duket sikur i rrëfen një dëshmitar i vërtetë që sheh çdo situatë që krijohet në atë fshat të largët, duke treguar kështu dhe situatat më problematike jo vetëm të atij fshati, por të të gjithë vendit dhe shoqërisë ku bëjnë pjesë.

Një nga dukuritë më interesante që vihen re në romanin “Arka e djallit” është shprehja e vetvetes në një shumësi emrash. Autori i veprës shihet i projektuar në figurën e shkrimtarit Sherif Abeceja në sjelljet e tij të sarta, në tiparin e tij të këmbënguljes për të zbuluar atë që të tjerët përpiqen ta mbulojnë, në heshtjen dhe dialogun me popullin. Ai shihet i projektuar tek figura e Cute Babules në mënyrën si ndërton humorin, si u heq cipën mashtrimeve, si sillet shpenguar në marrëdhëniet me të huajt, si i mund komplekset e veta dhe gjen shtigje e rrugëdalje edhe në situata të vështira, si i ndërton bisedat dhe lidhjet me fshatin dhe fshatarët, si preket e ligështohet pas gabimeve dhe qortimeve. Në figurën e Bamkë Dynjasë është një pjesë e fatit real të vetë shkrimtarit. Është fakt se Agolli pati nisur ta botonte “Arkën e djallit” në formën e fragmenteve, por fundi i saj që ndalimi, një sënduk njësoj si ai i “Shakasë së ndaluar” të Bamkës.

Nuk është e rastit që Agolli, duke e quajtur romanin e tij “Arka e djallit”, këtu duket shumë qartë përdorimi i simbolit që nënkupton sëndukun ku mbahet e kyçur vepra e ndaluar e Bamkë Dynjasë, i ka paralajmëruar atij një fund të trishtuar. Ndoshta autorësia e shumëfishtë (unë s’jam as Bamka, as Cutja, as Sherif Abeceja; ata janë personazhe të një veprë, ku shkrimtari ka qëndrimin e tij të qartë), mund të mos funksiononte si lehtësi dhe hile për të thënë atë që ishte e zorshme të thuhej. Ndoshta edhe romani i Agollit mund të përfundonte pikërisht në një sënduk të frikshëm, të cilin më pas dikush do të duhej ta zbulonte.

Duke mundur “vetëkufizimin”, me “Arkën e djallit” autori e çliroi letërsinë shqipe nga një prej pengesave më të mëdha. Deri më sot, sipas trajtimeve teorike të bëra, është e zorshme të gjendet një vepër tjetër ku autori të ketë arritur vetëshfaqjen jo vetëm në atë që ia ndalojnë të tjerët, por deri në atë që ia ndalon ai vetvetes.

Studim i mirëfilltë në aspektin gjuhësor

Rrafshi fonetik

Në romanin “Arka e djallit” autori ka përdorur disa dukuri të rrafshit fonetik. Disa nga shembujt më të spikatur në këtë roman janë:

- *defterin* për *defterin*. Në vend të përdorimit të zanoren *e* kemi zanoren *ë*.

Veçori të përgjithshme të gjuhës e të stilit në veprën “Arka e Djallit”...

- *don* për *donte*. Në këtë rast kemi rënien e mbaresës *të*. Kjo dukuri quhet apokopë, pasi kemi rënien e dy tingujve në fund të fjalës.
- *vetëdijë* për *vetëdije*. Në vend përdorimit të zanores *e* kemi zanoren *ë*.
- *paski* për *paske*. Edhe në këtë rast në vend të përdorimit të zanores *e* kemi zanoren *i*.
- *rrobe* për *rroba*. Në vend të përdorimit të zanores *a* kemi zanoren *e*
- *drojtja* për *ndrojtja*. Këtu kemi rënien e bashkëtingëllores *n* që ndodh në fillim të fjalës. Kjo dukuri quhet dukuri e aferezës.
- *lapangjozi* për *lapanjozi*. Kemi shtim të bashkëtingëllores *g* midis bashkëtingëlloreve *n* dhe *j*. Në këtë rast kemi dukurinë e epentezës, e cila është shtesa e një tingulli në trup të fjalës.
- *të mpleksura* për *të pleksura*. Nëpërmjet këtij shembulli kemi të bëjmë me shtimin e bashkëtingëllores *m*, në fillim të fjalës dhe kjo quhet dukuria e protezës. Ky shembull është marrë në faqen 8 të këtij romani.
- *të ngdhirë* për *të gdhirë*. Në këtë shembull kemi të bëjmë me shtimin e bashkëtingëllores *n*. Edhe në këtë rast, si në rastin më sipër, kemi të bëjmë me dukurinë e protezës.
- *zembrën* për *zembrën*. Në këtë shembull kemi të bëjmë me dukurinë e epentezës, pra shtimin e një tingulli në mes të fjalës. (f. 239).
- *qenq* për *qengj*. Në këtë shembull në vend të bashkëtingëllores *gj*, kemi përdorimin e bashkëtingëllores *q*.
- *flet* për *fletë*. Në këtë rast kemi rënie të zanores *ë* në fund të fjalës. Këtu kemi të bëjmë me dukurinë e apokopës. (f. 257).
- *gjishtërinjve* për *gishtërinjve*. Në këtë rast kemi përdorimin e bashkëtingëllores *gj* në vend të bashkëtingëllores *g*.
- *heshtëte* për *heshte*. Këtu kemi rastin e dukurisë së epentezës, si kemi shtim të tingujve *të* në mes të fjalës (f. 414).
- *cmira* për *smira*. Në këtë rast kemi përdorimin e bashkëtingëllores *c* në vend të bashkëtingëllores *s*.

Rrafshi morfologjik

Gjatë analizës së përgjithshme që i bëra romanit në rrafshin morfologjik, vura re se autori ka përdorur fjalë të larmishme përsa i përket fjalëformimit. Disa shembuj janë:

1. fjalë me formim parashtesor:

a. *superfuqi* → super + fuqi: është formuar me anën e parashtesës fjalëformuese *super* dhe emrit *fuqi* (f. 313).

b. *supershtet* → super + shtet: është formuar nga parashtesa fjalëformuese *super* dhe emri *shtet*, (f. 226).

c. *stërnip* → stër + nip :është formuar nga parashtesa fjalëformuese stër dhe nga emri nip

2. fjalë me formim prapashtesor:

a. *vrullshëm* → vrull + shëm, është formuar nga emri *vrull* + prapashtesën fjalëformuese *-shëm*, (f. 227).

b. *kufitare* → është formuar nga emri *kufi* +prapashtesa fjalëformuese tar + mbaresa trajtëformuese *e* (f. 53).

c. *kryetar* → krye + tar: është formuar nga emri *krye* + prapashtesën fjalëformuese *-tar* (f. 150).

3. formim parashtesor dhe prapashtesor njëkohësisht:

përparimtar → për + parimtar, parim + tar: është formuar fillimisht nga prapashtesa fjalëformuese *-tar*, pastaj prapashtesën fjalëformuese *-uar* (f. 43).

- *pakontrolluar* → pa + kontrolluar, kontroll + uar: është formuar fillimisht nga parashtesa mohuese fjalëformuese *-pa* + folja kontrollo + prapashtesë trajtëformuese të pjesores *uar*, pastaj folja *kontrollo* e formuar nga emri kontroll + prapashtesa fjalëformuese *o*.

- *patreguar* → pa + treguar, trego + uar: është formuar fillimisht nga parashtesa fjalëformuese mohuese *-pa* dhe nga pjesorja e foljes, pastaj nga folja trego + prapashtesa trajtëformuese *-uar*,

- *mosguxim* → mos + guxim, guxo + im: është formuar fillimisht folja *guxo* + prapashtesën fjalëformuese *-im* pastaj nga parashtesa fjalëformuese mohuese *-mos* + emrin guxim. (f. 149).

fjalë me prapashtesën *ëz, kë* që gjejnë një përdorim shumë të dendur në vepër si:

- *pakëz* → formuar nga ndajfolja *pak* + prapashtesa fjalëformuese *-ëz*.
- *sekretarkë* → formuar nga emri *sekretare* + prapashtesa fjalëformuese *-kë*
- *defterkë* → formuar nga emri *defter* + prapashtesa fjalëformuese *-kë*,
- *fletorkë* → formuar nga emri fletore + prapashtesa fjalëformuese *-kë*

formim me përbërje (kompozita):

Veçori të përgjithshme të gjuhës e të stilit në veprën “Arka e Djallit”...

- *zemërzjarr* → *zemër* + *thyer*: është formuar nga bashkimi emrit *-zemër* dhe emri *zjarr* (f. 200).
- *buzëkycur* → *buzë* + *kyçyr*: është formua nga emri *buzë* + mbiemri *i kyçur* (f. 250).
- *buzëqeshi* → *buzë* + *qeshi*: është formuar nga emri *buzë* + folja *qesh* +mbaresa trajtëformuese *i*
- *kundërveprim* → *kundër* + *veprim*: është formuar nga mbiemri *kundër* + emri *veprim*
- *qimeverdhë* → *qime* + (*i*) *verdhë*: është formuar nga emri *qime* + mbiemri *i verdhë* (f. 224).
- *fytyrëmbuluar* → *fytyrë* + *mbuluar*: është formuar nga emri *fytyrë* + mbiemri *i mbuluar* (f. 58).
- *trupgjatë* → *trup* + (*i*) *gjatë*: është formuar nga emri *trup* + mbiemri *i gjatë*
- *këndvështrim* → *kënd* + *vështrim*: është formuar nga emri *kënd* + emri *vështrim* (f. 225).
- *zemërgjerë* → *zemër* + (*e*) *gjerë*: është formuar nga emri *zemër* + mbiemri *i gjerë*, (f. 226).
- *Xhamthyer* → *xham* + (*i*) *thyer*: është formuar nga emri *xham* + mbiemri *i thyer*.

Kompozitat që autori ka përdorur më dendur në roman janë kompozita përcaktore.

Veçori të rrafshit leksikor

Në këtë roman shohim se autori ka përdorur një leksik të pasur me fjalë të brumit popullor. Disa nga këto fjalë të burimit popullor janë:

- *fillikat, kilota, iso, nur, sokaku* (f. 150)
- *qeleshe, demek, ahengjet* (f. 205)
- *në të gdhirë* (f. 159).

Një përdorim të dendur në këtë roman gjejnë dhe fjalë dialektore apo fjalët krahinore. Disa fjalë dialektore që gjenden më shpesh në roman janë:

- *llafoste – fliste*
- *ngahera – shpesh*
- *krejt – të gjithë*
- *gositë – festat* (f. 100)
- *kusinë – enë*
- *qoshe – cep*
- *pjell – lind* (f. 250)

- *qylaf – qeleshe*
- *çupën – vajzën*
- *lakrori – byrek* (f. 226)
- *zgërdheshje – ngërdheshje*
- *llapi – foli* (f. 149)

Fjalët krahinore më të përdorura në roman janë:

- *peripecitë – vështirësitë*
- *farmak – helm*
- *zarare – rrëmujë*
- *mbllaçit – përtypet*
- *qyfyre – shaka*
- *rrufit kafen – pi kafen (menjëherë)*
- *nëmur – mallkuar*
- *kërshëri – kureshtje*
- *të grish – të flasësh*
- *çoç – diçka*
- *u tulita – u drodha* (f. 226)
- *u gajas – u shkri*
- *njëçikë – pak* (f. 149)

Neologjizma të krijuara nga autori

- *kokosur vesh kapelen*
- *trokashka*

Fjalë të letërsisë artistike:

- *mavria – i mjeri* (f. 100)
- *i acartë – i ftohtë*

Por një përdorim të dendur në roman gjejnë kompozitat popullore të krijuara nga autori si: *fytyrëmbuluar, hundëthyerje, flokëbojatisur, trupgjatë, qafëthyeri, mustaqebukuri, bukashkelës*, etj. Përveç kompozitave popullore një përdorim të madh gjejnë dhe shprehjet popullore si:

Lëngu i hardhisë si gjaku i pleqërisë. S'ngopet barku me fjalën që dëgjon veshi.

Një përdorim të dendur në këtë roman gjejnë sidomos fjalë të ligjërimit bisedor. Në roman nuk mungojnë dhe fjalët e huaja si fjalët turke p.sh.: *efendi, çok gjyzel, boyrum, tepsi* etj. Dritëro Agolli në romanin “Arka e djallit” ka përdorur leksikun urban, leksikun politik-shoqëror dhe leksikun tekniko-shkencor. Por e veçanta e shkrimtarit në romanin e tij është leksiku potencial. Ky lloj fjalori është në harmoni të plotë me

Veçori të përgjithshme të gjuhës e të stilit në veprën “Arka e Djallit”...

biografinë dhe natyrën e tij krijuese. Leksiku rural i përdorur prej tij është dy llojesh:

1. Leksik bujqësor i lidhur me tokën, bimët dhe pemët e kultivuara apo natyrore. Leksiku i lidhur me tokën, ku fjalët më të përdorura në roman janë ato që kanë lidhje me dhe-në, *plis, baltë* etj. Leksiku i bimëve dhe i pemëve të kultivuara dhe përdorim më të shpeshtë kanë fjalët: *bar, tërfil, kashtë, gruri, misër, elb, pjepër, mollë, hardhi, qersh, dardhë, fik, patate, drithi, vresht, pjergullë, qepë* etj. Leksiku i bimëve dhe i pemëve natyrore dhe fjalët më të përdorura në roman përsa i përket këtij leksiku janë: *bar, gjemb, drizë, ah, lis, pyll, lajthi, frashër, lëndë, shkurre, dëllënjë* etj.

Leksiku që lidhet me rrugën dhe terrenin: *udhë, rrugë, rrugicë, shteg, brinjë, livadhe, kodra, male, gërxhe, brigje, sheshe, gurë, zall, fushë, shkëmb, greminë, hendek, rrëzë* etj.

Lesiku që lidhet me shtëpinë si objekt banimi: *shtëpi, vatër, tjegull, çati, prag, themele, lloz, portë, derë, dritare, haur, gardh, kotec, gurë, oborr, parmendë, plor, avlëmend, çikrik, grazhd, këmborë, zile* etj.

2. Leksiku që lidhet me kafshët dhe shpendët shtëpiake si dhe shpendët dhe kafshët e egra apo me insekte të gjithfarëllojshme:

Lesiku i kafshëve dhe i shpendëve shtëpiake: *kali, lopa, gomari, rosa, dhia, qengji, pela, pëllumbi, kau, demi, macja, maçoku, pula, këndesi, derri* etj.

Leksiku i kafshëve dhe i shpendëve të egra: *ujku, ariu, arusha, zogitë, bubuzheli, buburizi, zhaba, bretkosa, gjarpër, nepërkë, miu, urithi, sorra, bufi, iriqi, milingona, midhja, peshku, qefulli, derri i egër, kunadhja, dhelpra, sorkadhja, skifteri, keci, cjapi* etj. (f. 80).

Veçori të rrafshit sintaksor

Në veprën “Arka e djallit” Dritëro Agolli, përdor më shumë fjalitë e përbëra, sesa fjalitë e thjeshta. Te vepra e Dritëro Agollit, fjalitë njëkryepërbërëse gjejnë një përdorim shumë të paktë në numër dhe në këto raste e shohim zakonisht kur shprehet me një thirrje si në rastin:

“O Bemkë!” ose “Plaç!” - ku në rastin e parë shohim se thirrjet e shoqëron pjesëza *o*. Fjalitë e përbëra nënrenditëse kanë përdorim më të madh se fjalitë bashkërenditëse, madje dhe se sifjalitë e përbëra të përziera.

Duke u bazuar në klasifikimin e sifjalive nënrenditëse nëpërmjet fjalive të përbëra në roman shohim se sifjalia nënrenditëse filluese është më e përdorur në krahasim me sifjalitë e tjera nënrenditëse. Në bazë të funksionit që kryejnë sifjalitë filluese në këtë vepër na del më shpesh e

përdorur sifjalia përcaktore dhe sifjalia kundrinore. Sifjalitë rrethore (*kohore, vendore, rrjedhimore, lejimore, kushtore, mënyrore, qëllimore*) janë më të pakta në numër, krahasuar me sifjalitë përcaktore dhe kundrinore. Rendi i sifjalisë kryesore të vepra e Agollit, ashtu si në gjuhën shqipe gjen përdorim më të madh në fillim të fjalisë së përbërë, madje dhe në rastin kur kemi dy ose tri sifjali kryesore në një fjali të përbërë, por sifjalia kryesore mund të gjendet edhe në mes të fjalisë së përbërë dhe shumë rrallë, sifjalia kryesore ndodhet në fund të fjalisë së përbërë. Dritëro Agolli në fjalinë e përbërë përdor më shumë kallëzuesit foljorë të thjeshtë, si *mori, kuptoi, u ul, hodhi, ndante* etj., por autori përdor dhe kallëzuesin emëror si (*ishte i madh, është e çuditshme, jam një indus, ishte freskët*); përdoret dhe kallëzuesi i thjeshtë i ndërlikuar si (*dëgjoi sa dëgjoi*), përdoret kallëzuesi i përbërë modal, si: *mund të vështrojë, donte të shihte*; përdoret dhe kallëzuesi i përbërë aspektor si: *ke filluar të kesh, filloi të ecë*, por përdorimi i kallëzuesit të thjeshtë është më i shpeshtë dhe më i dendur se përdorimi i llojeve të tjerë të kallëzuesve.

Përdorim të dendur në veprën e Agollit kanë dhe format e pashtjelluara, sidomos mohorja dhe përcjellorja, të cilat kryejnë funksionin e rrethorit të mënyrës. Paskajorja si formë gramatikore në gjuhën shqipe ekziston edhe ka përdorim në të dy dialektet. Forma e shfaqjes së saj ndryshon, sigurisht edhe masa e përdorimit gjithashtu. “*Tipi i paskajores së gjuhës letrare i përbërë nga pjesëza para-fjalore për dhe emrin foljor asnjansë i pashquar (për të punuar) ekziston si tip i vetëm në të gjithë toskërishten dhe në atë të Shqipërisë së mesme, me një përdorim më të madh sidomos në të folmet kalimtare dhe në anët lindore të Shqipërisë së mesme, ai gjendet gjithashtu edhe në të folmet e tjera të gegërishtes*”² Për paskajoren e gegërishtes formën dhe përdorimin autorja shprehet në këtë mënyrë: “*Për të folmen e gegërishtes është tipike paskajorja e formuar nga pjesëza përemërore me dhe nga pjesorja e foljes (me punue). Në gegërisht kjo paskajore kryen edhe shumë funksione të lidhore. Në gegërishten veriore dhe në shumë të folme të gegërishtes qëndrore kjo paskajore është më dominuese*”³.

Në roman kemi përdorimin e pjesëzës mohuese **mos** në format e pashtjelluara, të shohim disa përdorime të këtij tipi më poshtë: “*Dilnin shpejt e shpejt për të mos këmbyer ndonje fjalë a për mos iu përgjigjur ndonjë pyetjeje..., Farja u bind dhe doli duke mos folur asnje fjalë...,*

² G. Elezi, *Gjurmime gjuhësore e interpretime të shqipes*, Shkup 2012, f. 114.

³ *Po aty*, f. 114.

Veçori të përgjithshme të gjuhës e të stilit në veprën “Arka e Djallit”...

Miku u ngrit në këmbë dhe duke mos i ndarë sytë nga fytyra shtrëngoi dorën..., Po ai vazhdonte të lexonte duke mos i dhënë rëndësi poteres..., Unë i kam shkukur nga fletorja e dytë e tij për të mos i lexuar asnjëherë ngaqë kam dashur ta mbroj...”

Kemi gjithashtu përdorime të togjeve me kundrina të drejta e të zhdrejta të shprehura me emra e përemra në rasën kallëzore e dhanore si edhe me anë trajtash të shkurtra përemrash vetorë, si: “E, mos ki frik, ai ska për ta falur!, Do të bëj letër në qeveri për ta ndaluar, - tha Anthulla..., mirë, mirë, dhe e zura për krahu për ta nxjerrë nga qilari..., I thashë për ta qetësuar. Jashtë bënte ftohtë dhe kjo të sillte në mendje zjarrin dhe dëshirën për t’u ngrohur...”

Format e pashtjelluara në funksion qëllimor, përcaktor, kallëzuesor në shembujt që vijojnë: “...për të treguar kolegëve dhe opinionit letrar të kryeqytetit se ai di të shkruaj edhe për fshatin më mire se kushdo..., Të dy pleqtë shkuan në kopsht për t’u zënë, që të mos i dëgjonte Sherif abecejja., Fshatarët u mblodhën për të marrë veshë se ç’kishte thënë Sherif Abecejja...,

E, mos ki frikë, ai s’ka për ta falur..., Sherif Abecese i duhen gjëra të bukura për të montuar në roman..., Posi! Tha plaka për të mbajtur veten dhe vazhdoi: posi!”. Këto forma të pashtjelluara i gjejmë sidomos te fjalitë e përbëra që ka përdorur autori.

Autori në sifjalitë nënrenditëse fülluese, përveç lidhëzave, përdor dhe përemrin lidhor që, pra fjalitë nënrenditëse lidhen dhe me fjalë leksikore lidhëse, si përemri lidhor dhe ndajfoljet lidhore, ndryshe nga fjalitë e përbëra bashkërenditëse, të cilat lidhen vetëm me lidhëza bashkërenditëse.

Meqenëse në këtë vepër një përdorim më të madh zënë fjalitë e përbëra nënrenditëse, vihet re se pikërisht në këto fjali kemi të bëjmë me një numër të madh sifjalish plotësore, si sifjali përcaktore dhe rrethanore, të cilat nuk janë të domosdoshme në fjali, dhe nëse i heqim, fjalia e përbërë vazhdon të ketë kuptim, sepse këto fjali plotësore, nuk mbartin asnjëherë peshë kuptimore të madhe. Nëse në fjalitë e përbëra nënrenditëse, sifjalitë plotëse hiqen dhe fjalia vazhdon ta ruajë kuptimin semantik të saj, në fjalitë bashkërenditëse nuk mund të heqim asnjë sifjali, sepse ato sifjali janë të gjitha kryesore dhe secila prej tyre të shkëputura nuk gëzojnë pavarësi të plotë, ndërsa në fjalitë e përziera vëmë re se kemi dhe sifjali kryesore bashkërenditëse, të cilat janë kryesore për kuptimin e fjalisë, kemi dhe sifjali të varura plotësore, për vetë faktin se fjalia e përbërë e përzierë përbëhet nga sifjali bashkërenditëse dhe sifjali nënrenditëse.

Nga shembujt e marrë nga materiali i vjelë shohim se fjalitë bashkërenditëse lidhen me lidhëza bashkërenditëse, të cilat qëndrojnë gjithmonë në indin e tyre, ndërsa në fjalitë nënrenditëse sifjalitë lidhen me lidhëza nënrenditëse, të cilat qëndrojnë në krye të sifjalive të varura, janë pjesë organike e tyre dhe mund të dalin edhe në krye të periudhës bashkë me sifjalinë së cilës i përkasin. Në sifjalitë e periudhave nënrenditëse nga shembujt që kemi marrë nga vepra “Arka e djallit” e Dritëro Agollit, shohim se ndodh që një sifjali qoftë kryesore ose e varur të hyjë në mes të një sifjale tjetër, ndërsa në fjalitë bashkërenditëse kjo gjë nuk ndodh kurrë.

Vëmë re se nëse sifjalitë e periudhave bashkërenditëse mund të bashkohen me lidhëza të përsëritura, kjo gjë nuk ndodh me sifjalitë nënrenditëse.

Shembuj fjalish të thjeshta ku tregohen dhe me se shprehen, si më poshtë:

*Sherif Abeceja po bëhej mit në Qershizë.*⁴

- *Sherif Abeceja* → SE sintagmë emërore e shprehur me emër
- *po bëhej mit në Qershizë* → SF sintagmë foljore e zbërthyeshme ku ndahet në:
 - *po bëhej* → SF sintagmë foljore
 - *mit në Qershizë* → SE sintagmë emërore e zbërthyeshme ku: mit → SE sintagmë emërore, dhe në Qershizë → SE sintagmë emërore.

Zëri i Sherif Abecesë dalëngadalë filloi të ulej.

- *Zëri i Sherif Abecesë* → SE sintagmë emërore e zbërthyeshme ku: zëri → SE sintagmë emërore, dhe i Sherif Abecesë → SE sintagmë emërore.
- *dalëngadalë filloi të ulej* → SF sintagmë foljore e zbërthyeshme ku ndahet në:
 - *dalëngadalë* → SNd. sintagmë ndajfoljore dhe *filloi të ulej* → SF sintagmë foljore e shprehur me kallëzues foljor të thjeshtë të zgjeruar, që tregon nisjen e një veprimi.
 - *Bamka i zi* → SE sintagmë emërore e zbërthyeshme, ku Bamka → SE sintagmë emërore dhe i zi → SMb. sintagmë mbiemërore.
 - *shtypi dorën e djathtë me të majtën* → SF sintagmë foljore e zbërthyeshme, ku *shtypi* → SF sintagmë foljore.

⁴ D. Agolli, “Arka...”, vep. e cit., f. 28.

Veçori të përgjithshme të gjuhës e të stilit në veprën “Arka e Djallit”...

- *dorën e djathtë me të majtë* → sintagmë emërore e zbërthyeshme ku *dorën* → SE sintagmë emërore, *e djathtë* → SE sintagmë emërore, *me të majtën* → SE sintagmë emërore.

Shembuj tipikë të rasteve të fjalive të përbëra në romanin “Arka e djallit”:

*Morava po e ndante më dysh, prandaj ai përpëlitej dhe nga dhimbja skuqte horizontin*⁵.

- *Morava po e ndante më dysh* → sifjali kryesore
- *prandaj ai përpëlitej* → sifjali kryesore bashkërenditëse përmbyllëse
- *dhe nga dhimbja skuqte horizontin* → sifjali kryesore bashkërenditëse këpujore.

Donte të thoshte diçka, i kapi pak spangot e buzëve të holla, por nga ato nuk doli asnjë tingull.⁶

- *donte* → sifjali kryesore
- *të thoshte diçka* → sifjali nënrenditëse kundrinore
- *i kapi pak spangot e brirëve të holla* → sifjali kryesore bashkërenditëse këpujore
- *por nga ato nuk doli asnjë tingull* → sifjali kryesore bashkërenditëse kundërshtore

*Ndërsa kishte dhe grupe të vogla fantazorësh nga kategori e pushtuarve që s’thoshin se Sherif Abeceja kishte zbritur në krahinën e tyre vetëm për shkakun e Anthullës, mjekes së Qershizës me të cilën ishte njohur shkarazi në Tiranë*⁷.

- *Ndërsa kishte dhe grupe të vogla fantazorësh nga kategori e të pushtuarve* → sifjali kryesore.
- *që s’thoshin* → sifjali nënrenditëse përcaktore.
- *se Sherif Abeceja kishte zbritur në krahinën e tyre për shkakun e Anthullës, mjekes së Qershizës* → sifjali nënrenditëse ffilluese. Kjo është sifjali kundrinore.
- *me të cilën ishte njohur shkarazi* → sifjali nënrenditëse përcaktore.

Sherif Abeceja nuk kishte ardhur në Qershizë ngaqë qënkësh zënë me gruan, me të cilën tashmë nuk bashkëjetonte as ngaqë paskësh dëshirë të

⁵ D. Agolli, “Arka...”, vep. e cit., f. 15.

⁶ *Po aty*, f. 10.

⁷ *Po aty*, f. 5.

*shkruante për fshatin, të cilin vërtet nuk e njihje mirë, as ngaqë kishte rënë në konflikt me qeverinë*⁸.

- *Sherif Abeceja nuk kishte ardhur në Qershizë* → sifjali kryesore.
- *ngaqë qenkësh zënë me gruan* → sifjali e varur nënrenditëse shkakore.
- *me të cilën tashmë nuk bashkëjetonte* → Kjo është sifjali përcaktore.
- *as ngaqë paskësh dëshirë* → sifjali nënrenditëse shkakore
- *të shkruante për fshatin* → Kjo është sifjali përcaktore.
- *të cilin vërtet nuk e njihje mirë* → Kjo është sifjali përcaktore.
- *as ngaqë kishte rënë në konflikt me qeverinë* → sifjali nënrenditëse shkakore.

Shembull tipik i fjalisë së përbërë të përzierë:

*Sherif Abeceja shkrimtar në zë dhe personalitet i dëgjuar i kulturës, u zhduk papritur nga Tirana dhe shkoi në një fshat të quajtur Qershizë në krahinën e Devollit për të ndjekur një çështje tepër misterioze, e cila, mesa duket, kishte rënë më shumë lidhje me një detyrim qytetar sesa letrar*⁹.

- *Sherif Abeceja shkrimtar në zë dhe personalitet i dëgjuar i kulturës, u zhduk papritur nga Tirana* → sifjali kryesore
- *dhe shkoi në një fshat të quajtur Qershizë në krahinën e Devollit për të ndjekur një çështje tepër misterioze* → sifjali kryesore bashkërenditëse këpujore
- *e cila, me sa duket, kishte rënë më shumë lidhje me një detyrim qytetar sesa letrar* → Kjo sifjali është sifjali përcaktore.

2. *Me këtë temë ai do t'i thyente hundët një shoqërie të tërë dhe do të tregonte se çdo temë në dorën e tij kthehet në një perlë*¹⁰.

- *Me këtë temë ai do t'i thyente hundët një shoqërie të tërë* → sifjali kryesore.
- *dhe do të tregonte* → sifjali kryesore.

se çdo temë në dorën e tij kthehet në një perlë. → sifjali e varur nënrenditëse fthilluese. Kjo sifjali është sifjali kundrinore.

Veçori të rrafshit stilistik

Një përdorim të dendur në këtë roman kanë fjalët me një ngarkesë të caktuar emocionale ose stilistike. Jo vetëm fjalët e krijuara nga autori

⁸ *Po aty*, f. 7.

⁹ D. Agolli, "Arka...", *vep. e cit.*, f. 5.

¹⁰ *Po aty*, f. 6.

Veçori të përgjithshme të gjuhës e të stilit në veprën “Arka e Djallit”...

mbartin në vetvete një peshë të caktuar emocionale dhe stilistike, por edhe fjalë të brumit popullor, apo shprehjet popullore të marra nga tabani popullor. Agolli ka zgjedhur pikërisht disa shprehje të burimit popullor dhe disa kompozita popullore për të treguar vlerat stilistike që ato kanë. Ja disa shembuj:

- bukëshkelur → me ngarkesë negative dhe përçmuese kundrejt një njeriu që nuk respekton asgjë.
- *mavria* → në këtë rast nuk kemi të bëjmë me një fjalë me nuanca kuptimore negative, duket sikur këtu ka nuanca kuptimore dhembshurie.
- *karagjoz* → i praptë, me nuanca kuptimore negative (f. 163).
- *arvanitis cingun* → Kjo sintagmë emërore ka nuanca dhe përbuzës dhe u drejtohet grekërve.

Autori ka përdorur gjithashtu edhe disa pasthirrma që mbartin një peshë të caktuar emocionale në situatë të ndryshme.

- *bu...bu...bu* (f. 80).
- *uh, e shkreta unë!*... (f. 250). Në këtë rast shpreh një mërztitje të madhe për diçka që ka ndodhur.
- *Ububu!* (f. 151).

Disa shprehje popullore me ngjyrimë stilistike janë:

Nusja e urtë, plasja e vjehrrës. Barku na zbardh faqen, barku na thyen qafën. Zogu që bërtet nuk është i majmë. (f. 90).

Një peshë të madhe emocionale mbartin dhe mallkimet e ndryshme si: *Plaç! Mortja! E martë e liga!* etj.

Në fund të këtij punimi mund të themi se në romanin “Arka e djallit” autori ka përdorur një numër të madh paskajoresh gege me ngjyrimë të shumta stilistikore. Paskajorja përveç funksionit të caktuar gjuhësor brenda fjalisë shihet edhe si një njësi e veçantë shprehëse. Autori e ka përdorur me mjeshtëri dhe origjinalitet të pashoq gjuhën. Thjeshtësia që e karakterizon, fjalori i thjeshtë popullor, me shprehje frazeologjike të shumta i jep akoma më tepër shprehësi dhe vlera të pakrahasueshme romanit në fjalë.

Përfundime

Gjatë analizës së këtij romani ndeshëm një shumëllojshmëri të fjalëve leksikore të fjalëve me burim popullor, të përdorura artistikisht. Autori është mbështetur shumë te burimi popullor i gjuhës sonë, por natyrisht, ka krijuar dhe neologjizma artistike. Agolli përdor një gjuhë të pasur të përbërë jo vetëm nga fjalët e standardit, por edhe ato me përdorim të dendur dialektor, krahinor, fjalë të gurrës popullore. Agolli me një

mjeshtëri të madhe artistike në bazë të fjalëve të brumit popullor, krijon kompozita të ndryshme popullore. Nëpërmjet detajeve Agolli krijon imazhe të plota të ngjarjeve, të personazheve të romanit dhe të peizazheve të ndryshme, duke i dhënë përshtypjen lexuesit sikur çdo gjë është qartësisht e dukshme në sytë e tij.

Te fjalë të ndryshme përsa i përket fushës së fonetikës kemi shndërrime fonetike të tingujve dhe dukurive të ndryshme që ndodhin si pasojë e proceseve gramatikore, si: dukuria e apokës, epentezës, aferezës, protezës etj. Përsa i përket fjalëformimit shohim se autori ka përdorur të gjitha modelet e fjalëformimit si: fjalë me parashtesë, prapashtesë, fjalë me parashtesë dhe prapashtesë njëkohësisht dhe kompozita të ndryshme. Agolli dhe pse njihet për fjalitë e tij të qarta dhe të shkurta, në këtë roman mbizotërojnë fjalitë e përbëra dhe numrin më të madh të këtyre fjalive e zënë fjalitë e përbëra me nënrenditje. Një numër shumë të vogël zënë fjalitë njëkryepërbërese. Fjalë të ndryshme në roman mbartin një vlerë të madhe stilistikore, emocionuese, por edhe figurative.

Ashtu siç ndodh në çdo krijim të Agollit edhe në këtë roman kemi mbështetje në gurrën popullore me fjalë, shprehje e mallkime të ndryshme. Nënteksti i romanit është i plotë, i qartë dhe i kuptueshëm edhe nga ana e lexuesit. Si përfundim mund të themi se Agolli është mjeshtër i një leksiku të pasur dhe sidomos mjeshtër përsa i përket fjalëve të burimit popullor, por pa lënë mënjanë edhe efektin emocional si fjalëkrijues e fjalëpasurues përmes një numri të madh neologjizmash vetjakë.

Në romanin “Arka e djallit” të D. Agollit kemi dendur përdorimin e pjesëzës mohuese **mos** në format e pashtjelluara. Kemi parë gjithashtu përdorime të togjeve me kundrina të drejta e të zhdrejta të shprehura me emra e përemra në rasën kallëzore e dhanore si edhe me anë trajtash të shkurtra përemrash vetorë. Gjatë studimit tonë e trajtuam me interes të veçantë çështjen e paskajores në gjuhën shqipe dhe efektet stilistike që ato fitojnë brenda kontekstit ligjërimit dhe ndeshëm interes të veçantë në këtë fushë.

Gjuha e romanit paraqitet e thjeshtë, por në të shfaqen dendur simbolika të thella, të cilat kërkojnë zbërthime të mëtejshme për të mbërritur në qëllimin final të vetë krijuesit. Këto zbërthime kalojnë përtej asaj që shihet në mënyrë të drejtpërdrejtë sepse gjuha e veprës letrare ndryshon nga të gjitha përdorimet e tjera të gjuhës. Gjuha e letërsisë i nënshtrohet një përpunimi të thellë artistik dhe duhet parë me vëmendje dhe imtësi të veçantë në çdo aspekt që të ofron.

BIBLIOGRAFI

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë,
Gramatika e Gjuhës Shqipe 1, 2, Tiranë, 2002.
- Agolli, D., *Arka e Djallit*, Shtëpia Botuese “Dritëro”, Tiranë, 1997.
- Çeliku, M., *Sintaksë e Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 2012.
- Dodi, A., *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2000.
- Elezi, G., *Gjurmime gjuhësore e interpretime të shqipes* 1, Shkup, 2012.
- Lloshi, Xh., *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2005.
- Memushaj, R., *Hyrje në Gjuhësi*, Botimet Toena, Tiranë, 2006.
- Memushaj, R., *Fonetika e shqipes standarde*, Botimet Toena, Tiranë,
2010.
- Memushaj, R., *Shqipja Standarde*, Botimet Toena, Tiranë, 2005.
- Solar, M., *Hyrje në shkencën për letërsinë*, Tiranë, 2006.

